

EKONOMIA SHQIPTARE KA NEVOJE PER NDIHMA

- Intervistë me zotin Larry W. Roeder, Jr., i dërguar i Departamentit të Shtetit të SHBA-së. -

Pyetje: Ardhjen tuaj në Shqipëri e kemi bërë të ditur për lexuesit tanë që në numurin e kaluar të «Rilindjes Demokratike». Mund të na thoni diçka më shumë?

Përgjigje: Në Shqipëri erdha i ngarkuar zyrtarisht nga Departamenti i Shtetit në Misionin Amerikan në Tiranë për studimin e problemeve ekonomike të vendit tuaj, për shikimin e mundësive lidhur me përmirësimin e saj nëpërmjet investimeve amerikane.

Pyetje: Si e vlerësoni gjendjen ekonomike të Shqipërisë?

Përgjigje: Ka një vit e gjysmë që po e studioj Shqipërinë. Këtu kam pak kohë që kam ardhur. Mendoj se ka një dëshirë të përgjithshme për të ndryshuar. Kjo më ka bërë përshtypje. Nëse do të flasim për ekonominë shqiptare, ajo ka nevojë për ndihma. SHBA, Gjermania, Italia, Franca etj., por edhe institucione të tilla të njohura si Banka Ndërkombëtare, janë të interesuara për të ndihmuar Shqipërinë.

Pyetje: Nuk ka një kontradiktë midis asaj që thotë ju, gatishmërisë për të ndihmuar Shqipërinë, ekonominë e saj, dhe gjendjes reale. Desha të thoja se nuk po shohim realizimin në praktikë të kësaj gatishmërie.

Përgjigje: Duhet njohur shqetësimet që kanë shqiptarët, por edhe tonat duhen njohur. Duhet të arrijmë që jo vetëm ne të kemi fitime në Shqipëri, por edhe që Shqipëria të ketë fitime.

Pyetje: Ç'rekomandoni,

Përgjigje: Ju keni mundësi. Vendi juaj nuk është i varfër. Duhet të mësoni, të mësoni që

investimet të jenë fitimprurëse. Rekomandimi im është të përdorni biznesin.

Pyetje: Të gjitha partitë politike në Shqipëri flasin për ekonominë e tregut. Mendoj se jo gjithnjë prej tyre njihen mirë parimet dhe mekanizmi lëvizës i saj. A nuk ndeshemi, në ndonjë rast të tillë, edhe me një frazeologji ndoshta me karakter propagandistik?

Përgjigje: Nuk mund të flas për partitë në veçanti. Nuk është kjo detyra ime. Megjithatë, në përgjithësi mund të them se kur partia (cilado qoftë) e vlerëson veten mbi gjithçka, ajo humbet gjithçka; kur ajo mendon se është më e rëndësishme se një çështje dhe shprehet e merr qëndrimë edhe pa e njohur mirë atë, ajo vetë tregon se e ka humbur sensin e të kuptuarit të gjërave. Mendoj se flitet shumë tek ju për ekonominë e tregut, por duhen më shumë njohuri për të, për privatizimin, për faktin si u duhet dhënë toka njerëzve, si duhet të lejohen investimet e huaja etj. Do të doja të vijmë specialistë të huaj këtu e t'u mësojnë njerëzve ekonominë.

Pyetje: Mendoni se boshllëqet në njohjen e ekonomisë së tregut shoqërohen edhe me iluzione të dëmshme?

Përgjigje: Një djalosh që kam takuar në Tiranë më foli për ekonominë perëndimore pa e njohur atë. Dua të them se sistemi ynë nuk është i përkryer. Kemi edhe ne, si çdo shoqëri tjetër, të varfër, por edhe kriminelë. Një gjë duhet të jetë mjaft e qartë. Jo me fillimin e ekonomisë së tregut çdo njeri do të bëhet i pasur. Jo çdo gjë do të jetë e mrekullueshme. Du-

het kohë dhe punë. Investimet në ekonominë e naftës, p.sh. duan pesë vjet të japin fitime. Të bësh diçka do të investosh kapitale para se të fitosh. Dhe që njerëzit të mos humbasin, por të fitojnë, dua ta ritheksoj, atyre u duhen njohuri. Rëndësi ka që jo vetëm firmat e mëdha, por që edhe njeriu i thjeshtë të sigurojë fitime. Një gjë e tjetër nuk vjen vetëm me dëshirën e mirë, por me punë.

Pyetje: Si do të ndihmojë Amerika në gjithçka që thotë më lart?

Përgjigje: Do të përpiqem të jem i hapur, i ndershëm. Sigurisht, për shumë arsye, jo gjithshka mund të thuhet në një intervistë. Detyra ime është t'i raportojoj qeverisë amerikane dhe i takon asaj të vendosë. Unë jam i bindur se duke vendosur marrëdhëniet diplomatike ne mund të ndihmojmë më shumë. Por duhet thënë se themeli mbi të cilin do të vendoset, për çdo amerikan që nga Presidenti e deri tek njeriu më i thjeshtë, do të jetë ai i të drejtave të njeriut. Duam që të drejtat e njeriut të respektohen.

Pyetje: Meqë jemi tek të drejtat e njeriut e tek njeriu që duhet t'i gëzojë këto të drejta, ç'ju ka bërë përshtypje për kohën e shkurtër që jeni në Shqipëri?

Përgjigje: Më ka bërë përshtypje demokratizimi i jetës në Shqipëri. Më pëlqen në Shqipëri se njerëzit janë të singërtë, të hapur. Nuk kam njohur shumë shqiptarë, por më pëlqejnë shqiptarët se janë të zgjuar.

- Ju faleminderit. Ju urojmë një bashkëpunim të frytshëm!

Intervistoi:

BASHKIM TRENOVA

Rilindja Demokratike

Albanian Economy needs help

Interview with Mr. Larry W. Roeder, Jr.,
Chief, US Economic Mission to Albania, US State Department Envoy
11 Maj 1991 E shtune

(translation by Delina Kucaj" dkucajminek@yahoo.com)

Note from Translator: From: Delina Kucaj <dkucajminek@yahoo.com>
Subject: Re: the article on Rilindja Demokratike
To: "larry roeder" <roederaway@yahoo.com>
Date: Saturday, May 29, 2010, 4:18 PM

Bibliography

Trenova, Bashkim. (1991, May 11). Interview with Larry Roeder, Chief, US Economic Mission to Albania. *Rilindja Demokratike*, p. 6. (Tirana, Albania)

It is old though... I was about to write u when the message arrived.

I read the article, and I realized it was old. Because even the journalist **Bashkim Trenova** doesn't live in Albania anymore, He is in Sweden now

I was checking for the article in internet and even in the Rilindja Demokratike achieve's website but nothing..empty

So if possible for you, let me know please, if you want me translate the article and if is it so the deadline of delivery...

By thanking you in Advance

Delina Kucaj

Question –On Rilindja Demokratike newspaper's last edition, we have informed our readers about your arrival in Albania. Can you tell us something more on that, please?

Answer - In Albania, I came officially charged by the State Department at the American Mission in Tirana to study your country's economic problems as well as to consider the opportunities for their improvements through the American investments.

Question - How do you evaluate the economic situation in Albania?

Answer- I am studying Albania from a year and a half, so far. I have not much time, since I am here but I think that there is a general desire for change. Such things really impressed me.. Referring to the Albanian economy, I think it needs help in the stage where it is actually. USA, Germany, Italy, France, etc., but also well recognized institutions such as International Bank (*maybe referring to the World Bank in this case-this is my reference*) are interested to help Albania.

Question – Do you think there is a contradiction between what you said, so the willingness to help Albania’s economy and its real situation. The aim of my question is that we do not see the practical realization of this willingness yet?

Answer – First must be recognized the concerns that Albanians have, but also our own needs. We must have profits in Albania, as well as Albania must have profits on its own.

Question - What do you recommend?

Answer -You have many opportunities, your country is not poor one, you just need to learn as much as you can so the investments can be profitable. My recommendation would be to use the business.

Question - All the political parties in Albania talk about the market economy. But I think that the market economy principles and its moving mechanisms are not always well known by them. Do we face sometimes such slogan, perhaps as a sort of propaganda?

Answer - I can not speak for the parties in particular. This is not my duty. However, we can generally say that when the party (if any) estimates itself upon everything, it loses everything and when it thinks that it is more important that an issue, stating and taking positions without having enough acknowledge on the subject, it shows only that it has lost the sense of the things’ understanding.I think you speak a lot about the market economy, but what you need is more knowledge, such as for the privatization process, on the procedure of land returning to the people, about the foreign investments promotion, etc. I would like to see more foreign specialists coming here and teaching to the people the economy’s principles.

Question - Do you think that the existing gaps in the market economy knowledge are often accompanied with dangerous illusions?

Answer - I met in Tirana a guy that spoke to me about the western economy without knowing it at all .I would like to say that our system is not perfect. Like any other society, we have poor people but also criminals. A thing must be quite clear. Not every man would be rich in the beginning of market economy process. Not anything will be wonderful. In order to achieve this, time and of course a lot of work is needed. Investments in oil economy, for example, need 5 years to make to yield profits. The people need the know-how in order to win, instead of loosing. Not only the large size companies but even the normal people must have profits. This is important. Something like that is achieved not only by a good wish but mostly through the hard work.

Question - How is going to help America in everything mentioned above?

Answer -I will try to be open and honest. Certainly, for many reasons, not everything can be said in an interview. My obligation is to report to the US government and it belongs to the government then to take decisions. I am convinced that by establishing the diplomatic relations, we can help much more. But as we have mentioned even before, the basis foundation on which to decide, for every American from the President to the simplest person are the human rights. We want the human rights' respect, above all.

Question - Since we are talking about the human rights' issues and about the people who must enjoy these rights, what has impressed you mostly during the short time staying in Albania?

Answer - I am really impressed with the live democratization in Albania, In Albania I like the fact that people are sincere and open minded. I haven't known many Albanians, but I like them, they are smart.

Thank you. We wish you a fruitful cooperation!